



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA-THE MUNICIPALITY OF SUHAREKE



MARRE NË DORËZIM - PRIMJENO - RECEIVED			
Nësi org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shifra Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	28279	30-06 2019

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dispozitave të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës lidhë këtë:

MARRËVESHJE E MIRËRKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

Lidhur ndërmjet palëve:

Komunës së Suharekës-përfaqësuar nga Bali MUHARREMAJ
Kryetar i Komunës në Suharekë

dhe

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale-përfaqësuar nga Drejtori
Bislim ZOGAJ

Neni 1 Qëllimi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, përfaqësuar nga Drejtori Bislim Zogaj, dhe në mes të Komunës së Suharekës, përfaqësuar nga Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës, me qëllim të financimit të projektit të përbashkët me titull:

“ Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve” në Komunën e Suharekës”

Neni 2

Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

- 2.1. Projekti për “ Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve ” arrin vlerën prej 125,000.00 Euro.
- 2.2. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale financon këtë projekt në vlerë prej 50,000.00 Euro.
- 2.3. Komuna e Suharekës financon këtë projekt në vlerën prej 75,000.00 Euro.

Neni 3

Obligimet e Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale

- 3.1. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale zotën mjetet për projektin nga neni 2 i kësaj marrëveshje dhe një kopje të zotimit e sjellë në Komunë të Suharekës pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.
- 3.2. Pagesa për financimin e projektit “ Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve” nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale do të bëhet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të organit mbikqyrës dhe Menaxherit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Suharekës.
- 3.4. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale mundet të cakton një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit “ Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve “ i cili do t'i raportojë Agjencisë.

Neni 4

Obligimet e Komunës

- 4.1. Komuna Suharekës obligohet që për projektin e “Renovimi dhe Mirembajtja e Lapidarëve” të zhvillojë procedurat e prokurimit për procesin e tenderimit, vlerësimit dhe dhënies së kontratës.
- 4.2. Komuna e Suharekës përmes procedurave të prokurimit zgjedh operatorin ekonomik dhe mbikëqyrë zbatimin e projektit.
- 4.3. Komuna emëron Menaxherin/ Organin mbikqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

4.4. Komuna është e obliguar të njoftoj Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale për rrjedhat e realizimit të projektit.

Neni 5

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

5.1. Marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale dhe Komuna e Suharekës përfundon me përfundimin e projektit.

Neni 6

Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes

6.1. Të gjitha palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësi në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike.

6.2. Me pëlqim të Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale dhe Kryetarit të Komunës kjo marrëveshje mundë të ndryshohet dhe të plotësohet.

Neni 7

Kjo marrëveshje partneriteti është përpiluarë në 4 ekzemplarë identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbasin për nevojat e organit kompetent.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj

PALET NË MARRËVESHJE

Agjencinë për Menaxhimin e
Komplekseve Memoriale

Beslim ZOGAJ
Drejtor



Komuna e Suharekës

Bali MULLAKREMAJ
Kryetari i Komunës



Date: 26/04/2019
Suharekë